




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644 – 19 – 4243 – 121/FA0109
14 Nr. 830/19
Dt. 29.08.2019

KONTRATË FURNIZIMI
(Kontratë Kornizë)

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Saranda Cakaj – Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**), dhe
2. “ **Elmi Kastrati B.I.** “ emri i biznesit **N.T.SH.** “**Meli-ek** “ me seli në **Malishevë**, me NrURB: **810705676** si **Operatorë Ekonomik**, të cilën e përfaqëson **z. Elmi Kastrati**, në tekstin e mëtejshëm **KONTRAKTUESI - FURNIZUESI**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike kornizë, për furnizime dhe/ ose shërbime, si vijon:

Furnizimi me shujtë – Krosantë për nxënës , me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	9	42	4	3	1	2	1
Nr. I brendshëm	644	1	9	0	6	6	1	2	1

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon :
Furnizimi me shujtë – Krosantë për nxënës të nivelit parafillorë dhe fillorë për 148 ditë mësimi, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : **644-19-066-121**
- 1.2 Kjo kontratë është **Kontratë Publike Kornizë** dhe fillon së zbatuari nga data: **02.08.2019** dhe përfundon më së largu deri më dt. **30.06.2020** duke përfshirë edhe këtë datë.
- 1.3 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. Psh, Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.
- 1.4 Sasi të e parapara, si në pjesën II. Lista e Çmimeve, (pjesë e Dosjes së Tenderit të Kontraktuesit – Furnizuesit) dhe të kësaj Kontrate janë vetëm sasi indikative. Ato paraqesin një prag, nga e cili mundë të lejohet një mospërputhje e cila nuk mundë të jetë më e lartë se plus / minus tridhjetë përqind (30 %).
- 1.5 Nëse Urdhërblertjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të Kontratës Publike Kornizë, duke përfshirë edhe tridhjetë përqindëshin, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, Kontrata Publike Kornizë do të ndërpritet automatikisht.

- 1.6 Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlenë edhe për pozicion / artikull si në Përshkrim të Çmimeve, dhe në rsat të arritjes së pragut të lejuar A.K. respektivisht Menaxheri i Kontratë dhe Komisioni i Pranimit të Mallit respektivisht Personi i Autorizuar nga Menaxhmenti i Shkollës nuk duhet të lejojnë të bëhen porosi tjera dhe / ose të bëhen pranime tjera të mallit për atë pozicion ose artikull.
- 1.7 Autoriteti Kontraktues është i obliguar të përdorë këtë marrëveshje kornizë kurdo që bëjnë blerjen e mallrave të përmendura në pikën 1.1.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Afati kohor për dorëzim të mallit të porositur do të jetë në baza ditore. Planifikohet të ushqehen me shuJtë 6400 nxënës të nivelit parashkollor dhe dhe fillor, për më së shumti 184 ditë, brenda kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.
- 2.2 Shujta duhet të transportohet e sigurtë deri në shkollë, dhe në shkollë duhet ti dorëzohet personit/ave të autorizuar nga Menaxhmenti i shkollës.
- 2.3 Shpërndarja e shujtës duhet të bëhet dy herë gjatë ditës, sipas ndërrimeve mësimore, respektivisht në ndërrimin e paradites dhe atë të pas ditës, sipas numrit të nxënësve në secilën shkollë të saktësuar në porosinë e bërë nga Menaxheri i Kontratës dhe / ose Personi i autorizuar i menaxhmentit të shkollës përkatëse.
- 2.4 Kontraktuesi merr për obligim që përgatitjen dhe transportin e shujtës ta bëjë në kushte teknike dhe sanitare sipas standardeve të pranuara, ndërsa transportin e shujtës deri në shkollë ta kryej në kushte hixhenike të përshtatshme dhe të pranueshme.
- 2.5 Pranim dorëzimi i kontingjentit të shujtës në cilësi dhe sasi duhet të konfirmohet me shkrim dhe nënshkrim nga personi i autorizuar dhe Kontraktuesi, në Raportin për pranim – dorëzim të kontingjentit të shujtës.
- 2.6 Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat e porositura brenda afatit kohorë të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë, për secilën ditë të vonesës t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.
- 2.7 Vendi i dorëzimit të furnizimeve të kontingjenteve të shujtës do të jetë institucioni shkollorë sipas Regjistrisë të Njësisë Kërkuese – Drejtorisë Komunale për Arsimit.
- 2.8 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimeve e paraqitur nga Furnizuesi.
- 3.2 Vlera totale indikativë e Kontratës është: 122.470,00€ (njëqindnjëzetedymijkatrëqindeshatdhjetë/00 Euro).
- 3.3 Çmimi i përmendur në Nenin 3.2 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve, me

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

përrjashtim nëse A.K. ka bërë porosi për furnizim me mall, duke shfrytëzuar edhe tridhjetpërqindëshin e lejuar sipas pikës 1.6. të nenit 1 të kësaj Kontrate Kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen : në pajtim me Kontigjentin e pranuar dhe të aprovuar nga Menaxheri i Projektit dhe të konfirmuar me Raportin me shkrim nga Komisioni i Pranimit të Mallit respektivisht personi i autorizuar i menaxhmentit të shkollës.

Shumat për furnizimet e përfunduara do të paguhen në afatin më të shkurtër kohorë, por jo më gjatë se 30 ditë kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore të kësaj Kontrate si dhe Kushteve të Përgjithshme dhe / ose Kushteve të Veçanta të Kontratës pjesë e Dosjes së Tenderit.

3.5. PAGESA E FUNDIT DO TË KRYHET PASI FURNIZUESI TË KETË PËRFUNDUAR GJITHA FURNIZIMET E POROSITURA PREJ MENAXHERIT TË KONTRATËS – KOMISIONI I PRANIMIT TË MALLIT TË AUTORITETIT KONTRAKTUES.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Pjesa B – Draft Kontrata;
- (c) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (d) Oferta financiare ;
- (e) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (f) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.





4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Kontraktuesin :
N.T.SH. "Meli-ek" – Malishevë

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Vushtrrisë

Emri:	Saranda Cakaj	Emri:	Elmi Kastrati
Pozita:	Drejtoreshë për Prokurim Publik	Pozita:	pronar
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	29.08.2019	Data:	29.08.2019
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Numri i prokurimit: VU644-19-4243-1-2-1 apo nr. i brendshem: VU644-19-066-121 Titulli:

Furnizim me shujta për nxënës

PJESA III E KONTRATES: kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës	Amandamenti i Nenit përkatës në KPK	
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : gjuha në përdorim zyrtarë.
Siguria e ekzekutimit	9.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është : 10 % e vlerës së përgjithshme të kontratës, nga një Bankë apo kompani e sigurimeve e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës. Në kohëzgjatje të periudhës prej 13 muajve nga data e nënshkrimit të kontratës.
Sigurimi	10.1	Sigurimi i ofertës N/A
Programi i ekzekutimit	11	Pas nënshkrimit të kontratës dhe duhen realizuar gjatë 12 muajve, nga data e hyrjes në fuqi e kontratës. Sipas Porosive të lëshuara nga Menaxheri i kontratës.
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	Gjitha detyrimet doganore dhe tatimore sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës, bien në barë të Op.Ek. - Kontraktuesit
Patentat dhe licencat	13.1	
Cilësia e furnizimeve	18.2	Pranimi paraprak është i nevojshëm dhe do të kryhet nga ana e Komisionit të Pranimit të Mallit.
Inspektimi dhe testimi	19.2	Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së mallit do të bëhet në momentin e dorëzimit për të gjithë artikujt që janë lënd e kësaj kontrate, nga Komisioni i Pranimit të Mallit, i emëruar enkas nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i furnizimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të Pranimit të Mallit të Autoritetit

Numri i prokurimit: VU644-19-4243-1-2-1 apo nr. i brendshem: VU644-19-066-121 Titulli:
Furnizim me shujta për nxënës

		Kontraktues.
Pagesa	20.1	Sipas Raportit të prezantuar – dorëzuara nga Menaxheri i Projektit dhe Komisioni i Pranimit të mallit. Pagesa do të kryhet në afatinë sa më të shkurtër kohor, por jo më gjatë se 30 ditë pas pranimit dhe evidentimit të faturës.
Dorëzimi	21.3	Livrimi i mallit duhet të realizohet në afatin kohor sipas orarit mësimor dhe atë për çdo ditë pune dhe në të dy ndrrimet. Dorëzimi i konsiderohet i përfunduar pas pranimit dhe konfirmimit të cilësisë së furnizimeve dhe / ose shërbimeve të pranuar Komisioni për pranimit të mallrave. Mallrat e dorëzuar duhet të kenë afat të përdorimit – e gjithë përgjegjësia bie mbi furnitorin
Obligimet e garancionit	24.1	Cilësia e mallit do të jetë përgjegjësi e furnitorit – Kontraktuesit.
	24.5	
Shërbimet pas shitjes	25.1	Në rast dështimi të mallit të pranuar Kontraktuesi merr për obligim që, me shpenzime të tija dhe pa asnjë kompesim nga Autoriteti Kontraktues, të bëjë ndrrimin mallit të pranuar.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, zgjidhje miqësore do të bëhet me ndërmjetësimin e Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike.

Mirënjohës, ju informojmë se kjo është një dokument i krijuar automatikisht nga sistemi dhe që përmban të gjithë të dhënat e nevojshme për të bërë një krahësim të saktë të shërbimeve të ofruara nga kompanitë të listuara më poshtë. Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi kontaktoni zyrën e klientëve të kompanisë së juaj të preferuar.

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia indikative për 184 ditë	Çmimi për njësi për TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSH)-Ç	Totali (Për TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
1	Krosantë me shembi të veshurës	Copë	235520	0.10	8.00	0.11	23,955.15	1,919.05	25,907
2	Krosantë me butësi pa kros	Copë	471040	0.08	8.00	0.10	43,514.51	3,455.19	47,104.1
3	Krosantë me kros	Copë	235520	0.08	8.00	0.10	21,507.01	1,744.59	23,552.0
4	Krosantë me shembi të manifestuar pa fang	Copë	235520	0.10	8.00	0.11	30,955.15	1,919.05	25,907.2
TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH:							113,398.52	9,071.88	122,470.40

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)

EMRI I OE: M.T.S.H. MELI EK

EMRI DHE MBEJMRI I PERFAQESUESIT TË OE: ELMI KASTRATI

NËNSHKRIMI: *[Signature]*

DATA: 09.07.2019

VULA:

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Përshkruaj specifikimet teknike, në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme të objektit të kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe të operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar të vendosë specifikime teknik që favorizojnë ose disfavorizojnë një ose me shumë operatorë ekonomik.

[2. Nëse variantet lejohen Autoriteti Kontraktues duhet të cekë specifikimet minimale që duhet të përmbushen nga një variant dhe çdo kërkesë specifike për prezantimin e variantit të tillë janë]

Nr.	Ditët	Përshkrimi	Sasia indicative për 184 ditë
1		Krosantët duhet të kenë peshë 80 gr (me mbushje), nga e cila duhet të ketë së paku 15 gram filling, ndërsa në përbërjen e brumit duhet të ketë 25% margarinë.	
2		Duhet të kenë pesë mbushje të ndryshme, të cilat servohen në ditët e caktuara.	
3	E hënë	2.1 Krosantët me xhem të vishnjës	235.520,00
4	E martë	2.2 Krosantët me putër pa kripë	235.520,00
5	E mërkurë	2.3 Kroasant me krem	235.520,00
6	E enjte	2.4 Krosant me putër pa kripë	235.520,00
7	E premte	2.5 Kroasant me xhem të manaferrave (pa fara)	235.520,00

Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është $\pm 30\%$

Numri i prokurimit: **VU644-19-4243-1-2-1** apo nr. i brendshem: **VU644-19-066-121** **Titulli:**
Furnizim me shujta për nxënës

Me këtë shujtë ushqimore planifikohet të furnizohen 6400 nxënës të nivelit parafillor dhe fillor për 184 ditë mësimi. Krosantët duhet të jenë të paketuara sipas standardeve të shpërndarjes së ushqimit. Duhet të transportohen të sigurta deri në shkollë, dhe në shkollë duhet të i dorëzohen personave të autorizuar nga menaxhmenti i shkollës.

Shpërndarja e shujtave duhet të shpërndahen dy here gjatë ditës sipas ndrrimeve mësimor, respektivisht në ndrimin e paraditës si dhe atë të pasëditës, sipa numrit të nxënve në secilën shkollë.

Operatori ekonomik duhet që pergaditjen ta bëjë në kushte teknike dhe sanitare sipas standaderdeve, si dhe transportin e shujtave deri në shkoll ta kryej në kushte hixhenike dhe të përshtatëshme.